





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
GJYKATA KUSHTETUESE

# Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese

*Vendimet nëntor-dhjetor 2025*



Buletini periodik i vendimmarrjes  
Nr. 6, nëntor-dhjetor 2025  
© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë





## HYRJJE

*Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.*

*Në këtë numër do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2025.*

## PËRMBAJTJA

Ankim kushtetues individual  
(vendime përfundimtare)

..... 4

**Parimi i autonomisë vendore – E drejta për t’u dëgjuar – E drejta për t’u mbrojtur**

## **FJALË KYÇE**

***Kryetari i bashkisë/ shkarkim nga detyra/ arrest në burg/ mosparaqitje në detyrë/ qeverisje vendore/ dekret i Presidentit për datën e zgjedhjeve/ luajtjet kushtetues***

**Shkarkimi i kryetarit të bashkisë bëhet vetëm në rast se ai ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës ose ligjeve. Ligjvënësi i zakonshëm nuk ka kompetencën për të parashikuar shkaqe të tjera ose më të gjera shkarkimi përtej shkeljes së rëndë kushtetuese ose ligjore. Masa e shkarkimit sjell pasojat të drejtpërdrejta në ushtrimin e mandatit të zgjedhur, ndaj organet publike kanë detyrimin pozitiv të sigurojnë aktivisht respektimin e të drejtave procedurale të organit të shkarkuar dhe të shmangin çdo praktikë që privon mundësinë reale të mbrojtjes.**

## **Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë (e drejta për proces të rregullt ligjor në procedurën e shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë) - vendimi nr. 66, datë 03.11.2025**

### *Faktet*

Ndaj kërkuesit, kryetar i zgjedhur i Bashkisë Tiranë në vitin 2015, u vendos nga gjykatat masa e sigurimit “arrest në burg” për efekte të procedimit penal të nisur ndaj tij në vitin 2024. Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 69, datë 23.09.2025 i propozoi Këshillit të Ministrave shkarkimin nga detyra të kërkuesit, bazuar në nenin 62 shkronja “c”, të Ligjit për Qeverisjen Vendore, sipas të cilit kryetari i bashkisë shkarkohet për mosparaqitje në detyrë për një periudhë tremujore të pandërprerë, duke mos i atribuar atij ndonjë sjellje të kryer me faj. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 539, datë 25.09.2025 vendosi shkarkimin nga detyra të kërkuesit. E gjithë procedura administrative për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të bashkisë zgjati vetëm 5 ditë. Lidhur me këtë procedurë kërkuesi nuk u njoftua për t’u dëgjuar dhe as nuk iu njoftuan aktet respektive. Në vijim kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual ku kërkoi shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave.

Mbi njoftimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e vakancave për kryetarë në gjashtë bashki të vendit, përfshirë edhe Bashkinë e Tiranës dhe caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme, Presidenti dekretoi në datën 01.10.2025 datën e zgjedhjeve edhe për Bashkinë Tiranë. Kërkuesi iu drejtua sërish Gjykatës, duke kërkuar edhe shfuqizimin e dekretit për caktimin e zgjedhjeve dhe pezullimin e efekteve të tij për pjesën që caktonte datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë Tiranë. Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi pezullimin e dekretit për pjesën që përcaktonte datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për juridiksionin kushtetues* – Gjykata ka kompetencën për të kontrolluar vendimin e Këshillit të Ministrave për shkarkimin e organit të qeverisjes vendore, pavarësisht shkakut të referuar në atë vendim. Formula e shkarkimit të kryetarit të bashkisë nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rëndë kushtetuese dhe ligjore, e parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, përbën mbikëqyrje administrative të pushtetit qendror ndaj veprimtarisë së pushtetit vendor. Ankimi kushtetues i kryetarit të bashkisë ndaj vendimit të shkarkimit është mekanizëm thelbësor mbrojtës i autonomisë vendore dhe balancimit të pushteteve. Ligji nuk ka epërsi ndaj Kushtetutës, ndaj nuk mund të krijojë shkaqe të reja të shkarkimit, përtej parashikimit kushtetues. Gjykata ka kompetencën të kontrollojë edhe dekretin e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve, për shkak të lidhjes funksionale që ai ka me vendimin e shkarkimit të organit të zgjedhur vendor. Këto dy akte nuk janë normative, por janë të njëpasnjëshme në procedurën e zgjedhjes së organit të ri vendor në vendin vakant të krijuar nga shkarkimi dhe i shërbejnë të njëjtit qëllim kushtetues, ndaj kontrolli i tyre nuk mund të ndahet. E kundërta do të dëmtonte vërtetimin e fakteve të mosmarrëveshjes dhe rrezikonte koherencën e akteve juridike.

*Për të drejtën për proces të rregullt ligjor të shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë* - Gjykata vlerësoi se vendimi i shkarkimit të kërkuesit nga detyra është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, i zhvilluar nga këshilli bashkiak dhe Këshilli i Ministrave, që ka sjellë si pasojë cenimin edhe të parimit të autonomisë vendore. Organi publik ka detyrimin pozitiv për të ndërmarrë aktivisht të gjitha masat e domosdoshme procedurale për të garantuar një proces të drejtë. Mosnjoftimi i kërkuesit për arsyet, bazën ligjore dhe ecurinë e procedurës, si dhe mosmarrja e masave të nevojshme për t’i mundësuar atij ushtrimin efektiv të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, krijuan një situatë në të cilën pjesëmarrja e tij u bë iluzore dhe formaliste. Prandaj vendimi për shkarkimin e organit të zgjedhur vendor është marrë duke cenuar thelbin e garancive kushtetuese deri në asgjësimin e tyre.

*(vijon në faqen 5)*



Përmbajtja eksplicite e nenit 115 të Kushtetutës për shkaqet e shkarkimit nuk i jep ligjvënësit të zakonshëm kompetencën për të parashikuar shkaqe të tjera ose më të gjera shkarkimi përtej shkeljes së rëndë kushtetuese ose ligjore. Ndonëse, ligjvënësi nuk ka përcaktuar se mungesa tremujore e parashikuar në nenin 62, shkronja “c” të Ligjit për Qeverisjen Vendore duhet të jetë e pajustificuar, e qëllimshme ose e varur nga vullneti i organit të qeverisjes vendore, kjo dispozitë nuk mund të interpretohet në mënyrë të shkëputur nga neni 115 i Kushtetutës. Çdo interpretim i nenit 62 të ligjit për qeverisjen vendore duhet të garantojë që zbatimi i tij të mos lejojë që rrethana faktike që nuk burojnë nga sjellja e vet kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të konsiderohen automatikisht shkelje e rëndë e Kushtetutës ose e ligjeve. Mosparaqitja në detyrë për një periudhë të pandërprerë tre-mujore mund të përbëjë shkelje të rëndë në ushtrimin e detyrës nga kryetari i bashkisë, por gjithnjë kur ai mund dhe duhet të mbajë përgjegjësi, në ndryshim nga rasti konkret, ku kërkuesit nuk i atribuohet asnjë lloj përgjegjësie juridike. Zbatimi mekanik i një dispozite ligjore pa u lidhur me kriterin material kushtetues, përbën shmangie nga rendi kushtetues dhe cenon garancitë thelbësore të ushtrimit të mandatit të përfaqësimit vendor.

*Për dekretin e caktimit të zgjedhjeve* – Gjykata evidentoi se Presidenti ka nxjerrë dekretin, edhe pse vendimi i shkarkimit të Këshillit të Ministrave, për shkak të paraqitjes së ankimit kushtetues nga ana e organit të zgjedhor vendor, ishte i pezulluar *ipso iure* sipas nenit 115 të Kushtetutës. Ai ishte i detyruar të priste vendimin përfundimtar të Gjykatës dhe vetëm në rast të lënies në fuqi të vendimit për shkarkimin nga detyra, mund të ushtronte kompetencën e tij. Kompetenca në fjalë duhet të ushtrohet sipas parimit të luajalitetit kushtetues. Ajo synon t'i japë legjitimitetin e nevojshëm demokratik zgjedhjeve të parakohshme që do të zhvillohen, në kuptim të rolit neutral kushtetues të Presidentit, jo vetëm për të përfaqësuar unitetin e popullit dhe për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm, por edhe për të garantuar procesin e rregullt dhe parimin e autonomisë vendore. Në përfundim, Gjykata vlerësoi se dekreti i Presidentit, për pjesën që ka caktuar datën e zgjedhjeve në bashkinë Tiranë, ka dalë në shkelje të parashikimeve kushtetuese dhe duhet të shfuqizohet.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës.

## Parimi i prezumimit të pafajësisë - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

### FJALË KYÇE

*Person i zhdukur/ mungesë kufome/ prezumim vdekjeje/ indicie/ dënim pa prova/ prova shkencore/ njolla gjaku/ test ADN-je/ vlerësim provash/ prova determinante/ barrë e provës/ prezumime faktike dhe ligjore/ dyshim i arsyeshëm*

**Për të hetuar një zhdukje të dyshimtë dhe një vdekje të dyshimtë, analiza duhet të fillojë me zbulimin e trupit, të armës së krimit, të vendit të krimit, të motivit e të mekanizmit të vrasjes dhe në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë analizuar vlerën provuese të njollave të gjakut të lidhur me mungesën e një trupi në drejtim të fajësisë, për sa kohë që nuk rezulton të jetë gjetur as arma e krimit.**

**Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsytuar se kërkuesi nuk ka bashkëpunuar për të treguar vendndodhjen e trupit të viktimës, por kjo nuk është e mjaftueshme për të justifikuar prezumimin e faktit.**

## Aleksandër Fadili (cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor) - vendimi nr. 67, datë 05.11.2025

### Faktet

Kërkuesi ka bërë kallëzim në Komisaratin e Policisë Kurbin, pasi kishte humbur kontaktet me shokun e tij, me të cilin ishin edhe në marrëdhënie pune, shtetasin F.F.

Prokuroria e Kurbin, pas veprimeve hetimore, ka marrë të pandehur kërkuesin, pasi sipas saj, janë krijuar dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se shtetasi F.F. është vrarë me qëllim vjedhjen e shumës së të hollave që kishte pasur me vete, dhe personi i fundit që kishte pasur kontakt me të, ishte kërkuesi. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka vendosur deklarinim fajtor për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me pasojë vdekjen” dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim. Vendimi është lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimet e të trija gjykatave.

### Vlerësimi i Gjykatës

*Për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme* - Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk legjitimohet për efekt të shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi këtë pretendim nuk e ka parashtuar në ankim dhe as në rekurs ndonëse në këtë të fundit e ka cituar me fjalë të përgjithshme. *Për parimin e paanshmërisë*, Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk kishte paraqitur argumente në nivel kushtetues.

*Për parimin e prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* - Gjykata analizoi tre kriteret për efekt të respektimit të garancive të parimit të prezumimit të pafajësisë:

(i) Kriteri i parë, *përcaktimi i drejtë dhe i qartë i fakteve të çështjes të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore*, për të cilin u shpreh se gjykatat nuk kanë arsytuar mjaftueshëm lidhur me faktin që nuk ka një kufomë, nëse shtetasi F.F. është zhdukur ose është vrarë dhe pse është prezumuar si i tillë apo pse zhdukja është prezumuar si vrasje.

(ii) Kriteri i dytë, *u analizua nga Gjykata i zbërthyer në tre nënkritere:*

*Për nënkriterin e parë: (a) përmbushja e detyrimit për barrën e provës duke evidentuar provat determinante* - Gjykata vlerësoi se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë përpjekur të përmbushin detyrimin për barrën e provës, duke evidentuar disa prova shkencore determinante, të cilat janë vlerësuar në unitet me njëra-tjetrën. Por, mënyra e arsytimit të tyre duket sikur ka çliruar prokurorin nga barra e provës dhe i ka kaluar kërkuesit, i cili sipas tyre, ka qenë në pozita mohuese dhe jo bashkëpunuese.

*Për nënkriterin e dytë: (b) respektimi i së drejtës për të mos u vetë-inkrimuar* - kjo e drejtë është interpretuar në mënyrë arbitrare, pasi gjykata e juridiksionit të zakonshëm ka pranuar ekzistencën e “mizorisë” në kryerjen e veprës penale, duke u bazuar vetëm në qëndrimin mohues të kërkuesit gjatë gjykimit, që ka refuzuar të tregojë trupin.

*Për nënkriterin e tretë: (c) nëse procesi ka filluar me bindjen se kërkuesi ka kryer veprën penale* - Gjykata vlerësoi se nuk rezulton që të ketë filluar hetimi dhe gjykimi me dyshimin dhe paragjykimin se kërkuesi është fajtor për vrasjen e F.F. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të kishin analizuar dhe arsytuar në mënyrë më të qartë lidhjen e faktit penal të vrasjes me kryerjen e vrasjes nga kërkuesi, në kushtet kur nuk është gjetur trupi i viktimës.

(vijon në faqen 7)

**Në çështjet penale nuk mund të shmangen edhe prezumimet e fakteve, por ato duhet të përdoren nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duke mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e interesit që rrezikohet për shkak të natyrës dhe llojit të veprës penale të lidhur me ashpërsinë e masës së dënimit, e cila ndikon drejtpërdrejt në garantimin e të drejtave substanciale të mbrojtjes.**

**Prezumimet e fakteve duhet të mbeten brenda kufijve të arsyeshëm, të cilët duhet të përcaktohen qartë përmes arsyetimit të vendimeve gjyqësore, që në rastin konkret duhet të fokusohet tek analiza përse fakti i vrasjes është prezumuar në kushtet e mungesës së trupit të viktimës, në analizë edhe të provave të tjera të grumbulluara në këtë proces penal.**

*(iii) Kriteri i tretë: nëse janë përdorur në mënyrë të arsyeshme prezumimet e faktit dhe prezumimet ligjore-* Gjykata vlerësoi se prezumimet e fakteve duhet të mbeten brenda kufijve të arsyeshëm, të cilët duhet të përcaktohen qartë përmes arsyetimit të vendimeve gjyqësore, që në rastin konkret duhet të fokusohet tek analiza përse fakti i vrasjes është prezumuar në kushtet e mungesës së trupit të viktimës, në analizë edhe të provave të tjera të grumbulluara në këtë proces penal. Nga vlerësimi i mësipërm, Gjykata arriti në konkluzionin se mënyra e arsyetimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për prezumimin e faktit të zhdukjes, vdekjes ose vrasjes dhe autorit të saj, nuk është e plotë dhe qartë. Ato kanë përmbushur në mënyrë jo të plotë detyrimin për t'iu përgjigjur kërkesit në arsyetimin e vendimeve gjyqësore për pretendimet e tij *për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë*, duke ceduar në analizën e një raporti të drejtë dhe harmonik të të gjithë ansamblit të provave që provojnë fajësinë, qofshin ato determinante/thelbësore të drejtpërdrejta ose indirekte, duke mbajtur në konsideratë se masa e kujdesit duhet të jetë në një nivel të arsyeshëm, për sa kohë jemi para një veprë penale, ku ashpërsia e masës së dënimit rrezikon ndjeshëm të drejtat kushtetuese substanciale.

Në përfundim, Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formal dhe nuk ka riparuar shkeljen e gjykatave të faktit, arsyetimi i të cilave ka qenë jo bindës, duke *cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë*.

*Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

## **E drejta për proces të rregullt ligjor-Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

### **FJALË KYÇE**

**Shoqëri tregtare/pronësi industriale/regjistrim marke ndërkombëtare/patentë/DPPM/pavlefshmëri absolute akti administrativ/ Konventa e Parisit/e drejta e prioritetit/Protokolli i Madridit/hierarki aktesh /transferim të drejtash**

**Në rastet e rihapjes së procesit, kufijtë e shqyrtimit të çështjes përcaktohen nga shkaku i rihapjes. Kjo do të thotë se, kur shkaku i rihapjes së procesit ka të bëjë me një shkelje e cila prek vetëm një pjesë të vendimit të dhënë, atëherë procesi rihapet vetëm për atë pjesë. Nga ana tjetër, në rastet e rihapjes së procesit, kërkuesi nuk mund të zgjerojë shkaqet e ankimit kushtetues fillestar dhe as të shtojë argumente të tjera në lidhje me to.**

**Në lidhje me themelin e çështjes për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, sipas njërës qëndrim, gjykatat e zakonshme kanë anashkaluar thelbin e pretendimeve të kërkueses, veçanërisht në drejtim të keqbesimit.**

**Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese thelbin e pretendimeve të ngritura nga palët në atë gjykim, duke u dhënë përgjigje veçanërisht, pretendimeve për keqbesim dhe të drejtave prioritare.**

## **Swinkels Family Brewers N.V. (rihapja e procesit në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së) - vendimi nr. 68, datë 05.11.2025**

### *Faktet*

Midis kërkueses (shoqëri tregtare holandeze që ka regjistruar në 2009 në pronësi të saj një markë tregtare) dhe subjektit të interesuar "Arseni" sh.p.k (shoqëri tregtare shqiptare) janë zhvilluar dy procese gjyqësore. Ky i fundit kishte blerë të drejtat e së njëjtës markë tregtare në vitin 2010 nga shoqëria maqedonase "N.D.L", e cila kishte regjistruar pronësinë e markës në Shqipëri pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) në 2008.

Në lidhje me proceset gjyqësore midis kërkueses dhe subjektit të interesuar, procesi i parë nisi mbi pretendimin e secilës "për pronësinë intelektuale" të markës tregtare, vendim i konfirmuar në favor të subjektit të interesuar në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Procesi i dytë u iniciua nga subjekti i interesuar pas regjistrimit ndërkombëtar të markës tregtare me logo të re nga kërkuesja. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shfuqizimin e regjistrimit të markës nga kërkuesja, vendim i lënë në fuqi në shkallët e tjera të gjyqimit.

Ky proces u ankimua nga kërkuesja në Gjykatën Kushtetuese, e cila vendosi rrëzimin e kërkesës në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike. Për sa i përket pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata nuk arriti kuorumin e nevojshëm ligjor për vendimarrje.

Kërkuesja, i është drejtuar GJEDNJ-së duke pretenduar cenimin e të drejtës së aksesit në Gjykatë dhe standardit të arsytimit të vendimit. Për këtë të fundit, GJEDNJ-ja gjeti shkelje dhe theksoi se forma më e përshtatshme e riparimit të shkeljes së gjetur do të ishte rihapja e procedurave të brendshme.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për rihapjen e procesit në Gjykatë* – Gjykata theksoi se në rastet e rihapjes së procesit, shqyrtohet vetëm pjesa e vendimit të dhënë, që ka përbërë shkelje.

Pretendimet e tjera të kërkueses, për të cilat GJEDNJ-ja nuk ka konstatuar shkelje, konsiderohen *res judicata*.

*Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, Gjykata në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimarrje, për rrjedhojë, kërkesa u konsiderua e rrëzuar.

*-Sipas njërës qëndrim*, pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit është i bazuar. Në drejtim të pretendimit të kërkueses për qenien në keqbesim të subjektit të interesuar, vendimet e gjykatave janë të paqarta dhe kontradiktore, për shkak se ndërsa argumenti i përdorur prej tyre për ekzistencën e gjësë së gjykuar do të duhej të pengonte shqyrtimin në themel të pretendimeve të paditëses, në fakt, rezultoi se ky pretendim është shqyrtuar në themel. Po kështu, gjykatat e zakonshme kanë anashkaluar thelbin e pretendimit për paligjshmërinë e regjistrimit kombëtar (në Shqipëri) të markës nga shoqëria maqedonase dhe fitimin në vijim të të drejtave nga subjekti i interesuar, në raport me faktet relevante dhe parimet për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale.

*-Sipas qëndrimit tjetër*, pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit është i pabazuar, pasi gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkueses, duke u dhënë atyre përgjigje të arsyetuar, veçanërisht atij për keqbesimin në veprimet e subjektit të interesuar dhe për të drejtën prioritare. Ato vendime nuk rezultojnë arbitrare, jologjike dhe të pamjaftueshme, apo kontradiktore ose të paqarta për sa u përket të dhënave të pasqyruara prej tyre. Vendimet përmbajnë mjaftueshëm arsytim në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes dhe zbatimin e ligjit, i cili nuk bie ndesh me standardet e një gjykimi të drejtë.

### *Vendimarrja*

Gjykata vendosi pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit dhe rrëzimin e ankimit kushtetues individual të kërkueses, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh në kuptim të nenit 73, pika 4 të ligjit nr. 8577/2000.

### Parimi i sigurisë juridike - Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

#### FJALË KYÇE

*Afat ligjor/ parashkrim/  
pension i parakohshëm/  
pavlefshmëri absolute/  
urdhër lirimi/  
dëmshtëpërblim/ afat i  
arsyeshëm*

**Gjykata ka pohuar se, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.**

**Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë.**

### Aleks Çela (*lirim nga shërbimi i SHISH-it*) - vendimi nr. 69, datë 06.11.2025

#### Faktet

Kërkuesi ka qënë i punësuar pranë SHISH deri në vitin 2006. Pavarësisht lirit nga shërbimi për shkelje të rregullave, kërkuesi është trajtuar me pension të parakohshëm, dhe në vitin 2014, pasi SHISH-i i ka vënë në dispozicion ekstraktin e urdhrin të lirit, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatën administrative me objekt pavlefshmëri absolute të urdhrin të lirit dhe zgjidhjen e pasojave dhe shpërblimin e dëmit me pagën e një viti. Gjykata ka vendosur mospranimin e padisë për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit ligjor 30-ditor, sipas ligjit për statusin e SHISH-it, si dhe jashtë afatit 3-vjeçar sipas nenit 203, të Kodit të Punës. Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, me arsyetimin se padia për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ mund të ngrihet në çdo kohë. Në rigjykim, Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Ndaj vendimit kanë paraqitur ankim të dyja palët. Në apel është vendosur ndryshimi i pjesës së vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar edhe se nuk ishte respektuar forma për nxjerrjen e aktit të lirit. Mbi rekursin e SHISH, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit për shkak se, padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

#### Vlerësimi i Gjykatës

*Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* - Gjykata vlerësoi se vendimi i gjykatës së apelit që ka kthyer çështjen për rigjykim nuk përbën gjë të gjykuar, pasi nuk ka zgjidhur çështjen e afatit të ngritjes së padisë në mënyrë përfundimtare. Gjykata e Lartë e ka argumentuar qëndrimin e saj se përse nuk qëndronte pretendimi i kërkuesit për pavlefshmëri absolute të urdhrin të lirit, duke vënë në dukje se argumentet e paraqitura nuk ishin bindëse. Në këtë kuptim, nuk rezultoi që arsyetimi i Gjykatës së Lartë të jetë me gabime faktike ose ligjore, të tilla që ta bëjnë atë haptazi të paarsyeshëm nga këndvështrimi kushtetues. Gjykata çmoi se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

#### Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

**Kriteret e legjitimitimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual – *Ratione personae - Ratione temporis***

## **FJALË KYÇE**

***Ekstradim/parashkrim i dënimit/ekzekutim/njohje e vendimit penal të huaj/masë sigurimi "arrest në burg"***

**Për sa kohë nuk evidentohet që ndonjë aspekt i së drejtës kushtetuese të pretenduar si e shkelur të jetë ende në rrezik, ankimi i kërkuesit ka humbur qëllimin thelbësor, pra mbrojtjen e së drejtës për të mos u ekstraduar dhe, në këtë kuptim, nuk evidentohet pasja nga ai e një interesi substancial.**

## **Bledar Bedini alias Imami (*interesi i kërkuesit për ankimin kushtetues mbi të drejtën për të mos u ekstraduar*) - vendimi nr. 70, datë 06.11.2025**

### *Faktet*

Kërkuesi u shpall në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane me qëllim ekzekutimin e dënimit me 7 vjet burgim si fajtor për veprën penale "*Trafikimi i lëndëve narkotike*" parashikuar nga legjislacionit italian. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi njohjen e vendimit penal të huaj dhe e dënoi me 7 vjet burgim. Pas gjykimit disa herë të çështjes nga gjykatat, Gjykata e Apelit rrëzoi kërkesën e prokurorit për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të huaj. Kundër këtij vendimi ushtroi rekurs prokurori dhe çështja u regjistrua në Gjykatën e Lartë. Kërkuesi u arrestua për qëllim ekstradimi.

Ndërkohë, pas kërkesës për ekstradim nga shteti italian, autoritetet shqiptare nisën procedurat përkatëse të ekstradimit. Mbi kërkesën e Prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin dhe lejimin e ekstradimit, ndërkohë që, pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit vendosi mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëroi lirimin e tij. Prokurori parashtroi në rekurs, ndër të tjera, edhe nevojën për unifikim të praktikës gjyqësore sa i takon nenit 10, paragrafi 2 të Konventës Europiane të Ekstradimit dhe shkronjës "ë" të nenit 491, të KPP-së.

Gjykata e Lartë pezulloi gjykimin dhe iu drejtua Gjykatës Kushtetuese mbi pajtueshmërinë e shkronjës "ë" të nenit 491 të KPP-së, e cila nuk lejon ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar, me nenin 39, pika 2, të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim e më pas Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor i cili lejonte ekstradimin.

Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual ku kwrkoi shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe refuzimin e ekstradimit.

Gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, autoritetet italiane revokuan kërkesën për ekstradim, në zbatim të vendimit të gjykatës italiane e cila vendosi shuarjen e dënimit me burgim, për shkak të parashkrimit sipas ligjit italian. Në këto rrethana kërkuesi iu drejtua me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë e cila vendosi lirimin e tij.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Legjitimitimi në lidhje me kriterin ratione personae* – Gjykata vlerësoi, se në kohën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual kërkuesi legjitimohej *ratione personae*, por në rrethanat aktuale ky kriter legjitimitimi plotësohet vetëm në aspektin procedural dhe jo në atë substancial. Qëllimi i ankimit kushtetues individual dhe interesi i kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë është pikërisht garantimi i së drejtës për të mos u ekstraduar. Kërkuesi nuk u ekstradua dhe nuk kishte procedurë ekstradimi aktive, gjithashtu dhe dënimi me burgim i cili qëndronte në themel të kërkesës për ekstradimin, nuk ekzistonte më. Situata që shkaktoi shkeljen e pretenduar të së drejtës për të mos u ekstraduar ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme, duke mos sjellë më rrezik për ekstradimin e tij. Në përfundim, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*.

Sa i takon *legjitimitimit në lidhje me kriterin ratione temporis*, Gjykata evidenton se, në lidhje me cenimin e lirisë personale, kërkuesi ka ngritur pretendime për paraburgimin e zbatuar ndaj tij me qëllim ekstradimin për periudhën 15.02.2022-20.12.2022, pra, për periudhën deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila vendosi mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëroi lirimin e tij nga paraburgimi. Gjykata shprehet se ankimi kushtetues individual ishte paraqitur nga kërkuesi në datën 24.12.2024, pas më shumë se 2 vjetësh nga heqja e kufizimit të lirisë personale. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është ngritur përtej afatit ligjor 4-mujor, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

**Kriteret e legjitimitimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual - Legjitimimi *ratione personae***

## **FJALË KYÇE**

**Procedurë votimi/komision votimi /zgjedhje e anëtarit të Gjykatës/ vakancë/ Mbledhje e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë/ Këshilli i Emërimeve në Drejtësi/ votë e pavlefshme/ pavlefshmëri ipso jure/ juridiksion kushtetues**

**Kërkimi për konstatimin antikushtetues të procesit zgjedhor të zhvilluar për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme dhe shfuqizimin e vendimit të kësaj të fundit, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës.**

## **Naureda Llagami (shfuqizimi i vendimit të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës) - vendimi nr. 71, datë 12.11.2025**

### *Faktet*

Kërkuesja ka kandiduar për vendin vakant për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) ka kryer procedurën e vlerësimit të kandidatëve dhe i ka dërguar listën përfundimtare me tre kandidatë Mbledhjes së Posaçme të Gjykatës së Lartë, ku kërkuesja është renditur e dyta. Gjatë procesit të votimit të Mbledhjes së Posaçme, kërkuesja ka marrë 8 vota, kandidati i renditur i pari 6 vota, ndërsa një votë është shpallur e pavlefshme, për shkak se kishte edhe një shenjë tjetër përveç shenjës në kutinë e caktuar për të shprehur vullnetin për kandidatin. Për rrjedhojë, referuar Ligjit Organik të Gjykatës, ku asnjë kandidat nuk ka arritur shumicën e 3/5-ve të votave të gjyqtarëve të pranishëm (9 vota), Mbledhja e Posaçme ka zgjedhur me vendim kandidatin A.V., të renditur i pari.

Kërkuesja i është drejtuar juridiksionit gjyqësor të zakonshëm, fillimisht me kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, pezullimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës, dhe më pas me kërkesëpadinë për shfuqizimin e atij vendimi dhe deklarimin e rezultatit në favor të saj. Në lidhje me kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, gjykata administrative e shkallës së parë, vendosi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe për pasojë mospranimin e shqyrtimit të kërkesës. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, ose në kërkim alternativ, shfuqizimin nga Gjykata të vendimit të Mbledhjes së Posaçme për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës dhe kthimin e çështjes Mbledhjes së Posaçme për të vendosur shpalljen e zgjedhjes së anëtares të Gjykatës kërkuesen.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për juridiksionin e Gjykatës*, - Gjykata konstatoi se, kërkuesja ka kërkuar nga Gjykata të ndalet në “verifikimin e zgjedhjes” së funksionarit në drejtim të shkeljes konkrete që ka të bëjë me (mos)ekzistencën e ndalimeve ligjore që do të përbënin shkak për konstatimin e pazgjedhshmërisë së funksionarit publik, duke kundërshtuar edhe aktin konkret që materializon shkeljen kushtetues të pretenduar, që është vendimi i Mbledhjes së Posaçme. Gjykata vlerësoi se kërkimi për konstatimin antikushtetues të procesit zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme dhe shfuqizimin e vendimit të kësaj të fundit, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata vlerësoi të mos marrë në analizë veçmas pretendimet e kërkueses për antikushtetueshmërinë e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, por t’i shohë ato të lidhura me analizën e saj për legjitimitimin e kërkueses mbi kërkimin për shfuqizimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme dhe të vendimit të komisionit të votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit.

*Për legjitimitimin e kërkueses*, - Pas vlerësimit të kriterit të parë të legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72/2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

*-Sipas njërit qëndrim*, kërkuesja, në cilësinë e individit, nuk legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet Gjykatës për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e funksionarit të organeve të parashikuara në Kushtetutë sipas nenit 131/1/e të saj. Kërkuesja si individ mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për çdo akt të pushtetit publik, siç janë edhe vendimet që ajo kundërshton, me ankim kushtetues individual sipas nenit 131/1/f, mirëpo kjo dispozitë për legjitimitimin e individit kërkon që akti i pushtetit publik t’i ketë cenuar atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta. Sipas këtij qëndrimi, e drejta për t’u zgjedhur në funksionin e gjyqtarit të Gjykatës nuk përbën të drejtë themelore kushtetuese, ndaj kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae*.

*-Sipas qëndrimit tjetër*, individët që garojnë për funksionet e parashikuara në Kushtetutë legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës për kushtetueshmërinë e procesit të zgjedhjes për sa kohë janë pjesë e atij procesi, sipas nenit 131/1/e, të Kushtetutës, bazuar edhe në nenin 134/1/i dhe 2, të Kushtetutës.

### *Vendimmarrja*

Në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh në lidhje me kriterin e legjitimitimit *ratione personae*, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa u konsiderua e rrëzuar.

**E drejta për proces të rregullt ligjor - E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj**

### **FJALË KYÇE**

***Kontratë publike ndërtimi/ zbatim kontrate/ zgjidhje mosmarrëveshje/arbitrazh ndërkombëtar/Dhoma Kombëtare e Tregtisë/ ekzekutim vendimi/ përmbaues privat/interes publik/pushim shqyrtimi i çështjes/akti i heqjes dorë/ parimi i disponibilitetit***

**Gjykata eidenton se për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues vepron parimi i disponibilitetit, sipas të cilit kërkuesit i njihet e drejta që procedurën e filluar prej tij ta ndërpresë përmes aktit të heqjes dorë. Ky i fundit, si rregull, passjell pushimin e shqyrtimit të çështjes, me përjashtim të rastit kur shqyrtimi i saj mbart interes publik.**

## **Shoqëria “VEGA” Sh.a. (pushim i gjykimit të çështjes për shkak të heqjes dorë nga kërkesa) - vendimi nr. 72, datë 17.11.2025**

### *Faktet*

Kërkuesja ka lidhur një kontratë me Ministrinë e Transportit dhe të Infrastrukturës (MTI), për ndërtimin e terminalit të trageteve Durrës në vitin 2008. Për mosmarrëveshje të lindura mbi zbatimin e kontratës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), e cila ka vendosur pjesërisht në favor të kërkueses.

Gjykata e Apelit Tiranë njohu vendimin e ICC-së dhe lëshoi urdhrin e ekzekutimit për këtë vendim. MTI-ja kreu në favor të kërkueses, pagesën e detyrimeve dhe kostove procedurale, por pa përfshirë interesat për vonesën.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (emërtimi i ndryshuar i MTI-së) paraqiti padi për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, si dhe kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit privat që kreu ekzekutimin, fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pastaj për kompetencë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo e fundit vendosi pranimin e padisë. Mbi ankimin e kërkueses dhe zyrës së përmbaimit, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe rrezuar padinë. Pas rekursit të paraqitur, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim.

Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual dhe Mbledhja e Gjyqtarëve, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në datën 29.10.2025 kërkuesja ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i ankimit kushtetues individual.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

Gjykata eidenton se neni 31/b i ligjit nr. 8577/2000 parashikon të drejtën e kërkuesit për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e gjykimit të çështjes dhe se heqja dorë nga kërkesa nuk pranohet kur Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes paraqet interes publik. Në këtë drejtim, arsyetoi nëse shqyrtimi i çështjes konkrete mbartte interes publik, në kuptimin e zbatimit të rregullit përjashtimor të parimit të disponibilitetit.

Pasi vërejti se ankimi kushtetues individual i kërkueses kishte objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, dhe se kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vlerësoi se nuk ka arsye bindëse për vazhdimin e gjykimit për shkak të një interesi publik, pasi pretendimet e kërkueses janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me cenimin e interesave të saj kushtetuese dhe në këto rrethana nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, pushimin e gjykimit të çështjes, bazuar në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000.

**Kriteret e legjitimitit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual – Shterimi i mjeteve juridike efektive**

## **FJALË KYÇE**

**Masë sigurimi “arrest në burg”/ mjet ankimi/ zëvendësim mase sigurimi/ kallëzim**

**Mjetet e ankimit, sikurse është edhe rekursi, kanë efekt dhe sjellin pasoja të drejtpërdrejta vetëm për individin që i ka ushtruar ato, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të caktuar.**

## **Mariglen Qato (ushtrimi i të drejtës së rekursit nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij) - vendimi nr. 73, datë 19.11.2025**

### *Faktet*

Prokuroria e Posaçme regjistroi procedim penal ndaj kërkuesit dhe shtetasit R.M., të punësuar në drejtorinë vartëse të Bashkisë Tiranë që prej vitit 2015. Pas veprimeve hetimore, mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë caktoi ndaj kërkuesit masën “Arrest në burg”. Në vijim, Prokuroria kërkoi verifikimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal dhe marrjen në pyetje të personave nën hetim, përfshirë dhe kërkuesin. GJKKO-ja vendosi vazhdimin e masës ndaj kërkuesit. Mbi ankimin e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit miratoi vendimet dhe në vijim Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi prishjen e vendimit e apelit për kërkuesin dhe personin nën hetim R.M., si dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim. Në rishqyrtim, GJKKO-ja e Apelit vendosi miratim të vendimeve të GJKKO-së në lidhje me llojin e masës së sigurimit të caktuar ndaj kërkuesit dhe shtetasit R.M.. Kërkuesi kundërshtoi masën e sigurimit dhe kërkoi zëvendësimin me një masë më të butë. Me kërkesë të njëjtë iu drejtuan GJKKO-së së Shkallës së Parë edhe dy personat nën hetim, shtetasit R.M. dhe T.T.. GJKKO-ja e Shkallës së Parë rrëzoi kërkesën e kërkuesit dhe të dy personave të tjerë nën hetim. Mbi ankimet e kërkuesit dhe shtetasit R.M., GJKKO-ja e Apelit miratoi vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Për rekursin e paraqitur nga shtetasi R.M., Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë la në fuqi vendimin e apelit.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Legjitimiti në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve* - Gjykata vëren se Gjykata e Lartë u vu në lëvizje nga rekursi i personit nën hetim R.M., pasi kërkuesi nuk paraqiti rekurs. Gjykata thekson se si rregull mjetet e ankimit, sikurse është edhe rekursi, kanë efekt dhe sjellin pasoja të drejtpërdrejta vetëm për individin që i ka ushtruar ato, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të caktuar. Gjykata konstaton se në rastin konkret e drejta e rekursit është ushtruar nga i bashkëpandehuri tjetër, ndërkohë që Gjykata e Lartë është shprehur në vendimin e saj vetëm për pretendimet e ngritura prej tij. Vendimi i Gjykatës së Lartë, edhe pse ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, pa përcaktuar se ndaj cilit prej të pandehurve ka prodhuar efekte, në fakt duket se ka prodhuar efekte dhe pasoja vetëm për individin që e ka ushtruar të drejtën e rekursit.

Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se për sa kohë që kërkuesi nuk ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nuk i ka ngritur në atë shkallë të gjykimit pretendimet që ka paraqitur në Gjykatë, ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja f, të Kushtetutës.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

### **E drejta për proces të rregullt ligjor - E drejta për gjykim të drejtë-Parimi i sigurisë juridike**

#### **FJALË KYÇE**

**Forca të Armatosura/ ish-oficer/ pension i parakohshëm/ vjetërsi shërbimi/ çasti i lindjes së të drejtës/ koha e kryerjes së veprimit konkret administrativ/ ligj material/ ligji nr. 8087/1996/ vendim unifikues nr. 3/2016**

**Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk mund të mjaftojë me një arsyetim të kufizuar, por duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve në rekurs të kërkesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke mbajtur në veçanti qëndrim për sa i përket kufizimit të masës së pensionit të kërkesit.**

**Duke pasur parasysh rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material.**

**Gjykata e Apelit nuk duket se ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë për llogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë.**

### **Bibë Kaza (cenimi i së drejtës për pension të parakohshëm në lidhje me interpretimin e gjykatave) - vendimi nr. 74, datë 20.11.2025**

#### **Faktet**

Kërkuesi, ish-oficer aktiv i Forcave të Armatosura me gradën “Kolonel”, i dalë në rezervë në vitin 2004 dhe përfitues i pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga data 01.08.2006, ka kundërshtuar mënyrën e përlllogaritjes së këtij pensioni nga DRSSH-ja, Tiranë, duke pretenduar shkeljen e kuadrit ligjor të zbatueshëm dhe kërkuar rillogaritjen e tij sipas ligjit nr. 9210/2004, si dhe pagesën e diferencave për periudhën 2006–2009. Padia e tij u pranua fillimisht nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, por u rrëzua nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, në përputhje me vendimin unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vlerësoi se pensioni ishte caktuar ligjërisht mbi bazën e ligjit nr. 8087/1996, përfshirë kufizimin e masës së tij. Mbi rekursin e kërkesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

#### **Vlerësimi i Gjykatës**

*Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike* - Gjykata konstatoi se Gjykata Administrative e Apelit e kufizoi pensionin e parakohshëm të kërkesit për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009 në masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke u mbështetur në nenin 11 të ligjit nr. 8087/1996 të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe duke vlerësuar se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohet për mungesë të daljes së akteve nënligjore për zbatimin e tij.

Gjykata çmoi se duke arsyetuar kështu, Gjykata e Apelit nuk kishte mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë për llogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë, dhe si rrjedhojë vendimi i apelit nuk duket se përmbush kërkesat e gjykimit të drejtë në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar përmbajtjen e ligjit nr. 9210/2004 dhe të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, si dhe mënyrën e interpretimit të tyre nga gjykata e apelit. Për pasojë, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm, edhe për sa i përket zbatimit të kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996 i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 01.08.2006 - 30.06.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm.

Përsa trajtuar, vendimi i Gjykatës së Lartë cenon të drejtën e kërkesit për gjykim të drejtë në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimin e sigurisë juridike për të drejtën e pensionit të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji.

#### **Vendimmarrja**

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin të kërkesës.

## E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

### FJALË KYÇE

*Kërkesë për rigjykim/afat i arsyeshëm/përshpejtim i procedurave të gjykimit/shpenzime gjyqësore/ Neni 399/3, pika 1 dhe neni 399/4, pika 2 të KPC-së*

**Mjetet e parashikuara nga KPC-ja për parandalimin dhe korrigjimin e shkeljes së afatit në rastin konkret nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe sjellja e autoriteteve ka sjellë cenim të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.**

**Kur kohëzgjatja e gjykimit ka qenë e konsiderueshme, Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm edhe në rastet që nuk kërkonin ndonjë trajtim të veçantë me përparësi, të tilla si mosmarrëveshjet për të drejtën e pronës të lidhura me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave.**

## Afroviti Xufa (konstatimi i cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm) - vendimi nr. 75, datë 20.11.2025

### Faktet

Kërkuesja ka kërkuar: anulimin e pjesshëm të vendimit të ZRKKP Vlorë (v. 2009) në lidhje me pasuritë (truall e ndërtesë); konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes; detyrimin e ZVRPP, Vlorë të fshijë pronën në emër të të paditurve dhe regjistrimin e saj në emër të kërkueses; anulimin e lejes së sheshit dhe të ndërtimit; marrjen e masës së sigurimit të padisë. Gjykata e Rrethit Vlorë ka pranuar padinë duke rrezuar kërkesën për sigurimin e padisë. Mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata e Apelit Vlorë, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i ka dërguar çështjen asaj për rigjykim. Më pas, mbi rekursin e palës së paditur, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë (2017). Ndërkohë që çështja ishte në pritje për t'u shqyrtuar, kërkuesja, ka paraqitur dy kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të saj (2023 e 2024). Në datën 25.11.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave të gjykimit, në bazë të neneve 399/5 dhe 399/6, pika 1/c, të KPC-së, e cila me vendimin e datës 16.01.2025, ka vendosur pushimin e gjykimit të saj, me arsyetimin se çështja civile ishte planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi në datën 29.01.2025. Në datën 09.06.2025, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm, duke kërkuar më pas edhe shpërblimin e shpenzimeve gjyqësore. Gjykata e Lartë ka shqyrtuar çështjen e kërkueses pak ditë përpara zhvillimit të seancës plenare, në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

### Vlerësimi i Gjykatës

*Legjitimitimi* - Gjykata vlerësoi se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* për kërkimin që synoi kontrollin kushtetues të përmbajtjes së neneve 399/3, pika 1, dhe 399/4, pika 2, të KPC-së, pasi nuk justifikoi interesin e saj real dhe të drejtpërdrejtë.

*Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, - Gjykata konstatoi se shqyrtimi i çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar dukshëm afatin 2-vjeçar të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, ndaj verifikoi kriteret që përcaktojnë kohëzgjatjen e arsyeshme në lidhje me:

i) Sjelljen e kërkueses- Kërkuesja nuk ka kontribuar në vonesa, dhe ka kërkuar në mënyrë aktive përshpejtimin e procedurave.

ii) Kompleksitetin e çështjes - Gjykata vërejtë se çështja nuk paraqitet komplekse.

iii) Sjelljen e autoriteteve - Gjykata evidentoi se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkueses ka tejkaluar afatin e arsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së, duke vlerësuar se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka ardhur për shkak të sjelljes së autoriteteve.

iv) Rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi - Gjykata vërejtë se, edhe pse çështja nuk hyn në kategorinë e interesave "jetësore" që kërkojnë trajtim me përparësi, ajo lidhet me të drejtën e pronës dhe proceset e kthimit dhe kompensimit të pronave, ku Gjykata ka konstatuar më parë shkelje të afatit të arsyeshëm. Gjykata çmoi se kërkesa e kërkueses pranohet vetëm për sa i përket konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

### Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

**E drejta për proces të rregullt ligjor— Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

### **FJALË KYÇE**

**Shoqëri tregtare/ central elektrik fotovoltaik/ taksë e ndikimit në infrastrukturë/ VKM/ leje ndërtimi/ autorizim/ tejkalim afati punimesh/ miratim projektvendimesh/ Këshilli i Ministrave/ Sekretar i Përgjithshëm/ rol aktiv dhe diskrecionar/ afat ligjor/ Rregullore për procedurat e dhënies së autorizimit**

**Arsytimi është element thelbësor i një vendimi të drejtë, argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë.**

## **Shoqëritë “Malsia Solar 1” Sh.p.k., “Malsia Solar 2” Sh.p.k., “Malsia Solar 3” Sh.p.k. (cenimi i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë) - vendimi nr. 76, datë 02.12.2025**

### *Faktet*

Kërkueset, kanë marrë nga Këshilli i Ministrave në vitin 2015 autorizimet përfundimtare për zbatimin e projektit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik me afat përfundimi dy vjet (mars 2017). Për shkak të mosdakordësisë me Bashkinë e Malësisë së Madhe për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.1% apo 3%), kërkueset nuk kanë marrë në kohë lejet e ndërtimit për fillimin e punimeve. Në vitin 2018 kërkueset kanë kërkuar pajisjen me lejen e ndërtimit, por për shkak të tejkalimit të afatit të përcaktuar në VKM-në për dhënien e autorizimit, kjo nuk u bë e mundur. Pas komunikimeve në rrugë administrative, me qëllim shtyrjen e afateve të punimeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikes ka dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave tre projektvendime, të cilat nuk janë miratuar, me përgjigjen se kërkesa për shtyrje është paraqitur jashtë afateve ligjore. Në këto rrethana, kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, ndër të tjera, pranoi pjesërisht padinë dhe detyroi Këshillin e Ministrave të miratojë tre projektvendimet në fjalë. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, por Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, prishi vendimet e dy gjykatave të faktit dhe rrëzoi padinë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Kërkueset i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

Në lidhje me *cenimin e së drejtës së pronës*, Gjykata çmoi se në kushtet kur autorizimi për ndërtimin e projektit ka qenë paraprak dhe investimi nuk është përmbushur, nuk ka bazë të arsyeshme që të mbështesë ndonjë prishmëri legjitime.

Sa i takon *cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime:

*-Sipas njërit qëndrim, u vlerësua se pretendimi i kërkueseve për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është i bazuar, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse ka analizuar parashikimet ligjore që gjejnë zbatim në interpretimin e rrethanave dhe fakteve të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, nuk i ka trajtuar ato të ndërvarura me njëra-tjetrën, duke mos mbajtur në konsideratë faktin se kërkueset kanë qenë në pamundësi objektive dhe përtej vullnetit të tyre për të përmbushur dhe realizuar projektin sipas autorizimeve të marra nga Këshilli i Ministrave. Kjo çështje dhe dinamikat e saj nuk janë analizuar dhe as vlerësuar me objektivitet nga Gjykata e Lartë, duke bërë që arsyetimi i saj formalisht të mbështetet vetëm në parashikimet ligjore pa marrë në konsideratë rrethanat dhe faktet e çështjes, për më tepër të provuara dhe të pranuar edhe nga vetë institucionet.*

*-Ndërsa sipas qëndrimit tjetër, pretendimi i kërkueseve për cenimin e standardit të arsytimit është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë arsye të mjaftueshme për vlerësimin e saj në raport me dispozitat ligjore të aplikueshme që e kanë çuar në zgjidhjen e çështjes sipas përmbajtjes së dispozitivit. Vendimi rezultoi të jetë i qartë në përmbajtje dhe pjesët përbërëse të tij janë të lidhura me njëra-tjetrën, ndërsa pjesa arsyetuese paraqet interpretimin ligjor bazuar në rrethanat dhe faktet e çështjes, që nuk përmban gabime faktike ose ligjore.*

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4 të ligjit nr. 8577/2000.

## E drejta e aksesit – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

### FJALË KYÇE

*Shërbim civil/ masë disiplinore/ procedim disiplinor/ legjitimim pasiv/ pavlefshmëri absolute/ pavlefshmëri relative/ nenet 116 e 118, të KPA-së/ shqyrtim de plano i çështjes*

**E drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal.**

**Kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues.**

**Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor.**

## Klodiana Cankja (*paliqshmëria e aktit të largimit nga detyra*) - vendimi nr. 77, datë 02.12.2025

### Faktet

Kërkuesja është larguar nga detyra e drejtoreshës së përgjithshme të APP-së pas marrjes së masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për shkelje të procedurave disiplinore në ushtrimin e detyrës së saj. Duke mos qenë dakord me vendimin e largimit nga detyra, kërkuesja ka paraqitur padi kundër Këshillit të Ministrave, duke kërkuar anulimin e këtij vendimi, rikthimin në pozicionin e punës, si dhe pagimin e pagës. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë për shkak të moslegjitimit pasiv të palës së paditur, qëndrim i mbajtur edhe nga gjykata e apelit, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të saj. Në vijim, kërkuesja i është drejtuar sërish gjykatës administrative së shkallës së parë, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të largimit nga detyra, kthimin në vendin e punës ose në një pozicion të barasvlershëm me të, si dhe dhënien e pagës si drejtoreshë e përgjithshme e APP-së. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, qëndrim i mbajtur edhe nga gjykata administrative e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

### Vlerësimi i Gjykatës

*Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*- Gjykata vlerësoi nëse kërkuesja ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin thelbësor të parashtruar gjatë gjykimit të çështjes së saj, që kishte të bënte me (pa)ligjshmërinë e procedurës së nxjerrjes së aktit të largimit të saj nga detyra. Në lidhje me këtë, Gjykata vërejtë se, ndonëse në objektin e padisë së kërkueses është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit për largimin nga shërbimi civil, mbi shkakun se ai është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, duke iu referuar për këtë KPA-së në fuqi (neni 116, shkronja “c”), gjykatat e zakonshme të faktit, këtij pretendimi të kërkueses, i janë përgjigjur se, në thelb, përmes tij, kundërshtojë ligjshmëria e aktit administrativ, pra, synojë pavlefshmëria relative e tij sipas nenit 118 të KPA-së, çka, sipas tyre, përbënte gjë të gjykuar. Po ashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar edhe se akti i largimit nga detyra nuk paraqet elemente të pavlefshmërisë absolute, pasi është marrë nga një organ administrativ i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij, referuar shkronjave “a” dhe “b” të nenit 116 të KPA-së, por pa vënë në diskutim dhe kthyer përgjigje për shkakun e pretenduar nga kërkuesja sipas shkronjës “c” të këtij neni.

Ndërkohë, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, megjithëse ndodhej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, atë të së drejtës së aksesit, në ushtrim të funksionit të saj dhe parimit të subsidiaritetit duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkueses. Mospranimi i rekursit të kërkueses nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkueses. Gjykata arriti në përfundimin se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

### Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës (një gjyqtar është shprehur me mendim pakice).

**E drejta për të mos u dëbuar – Parimi i reciprocitetit**

## **FJALË KYÇE**

**Gjykatë e huaj/ Interpol/ dënim penal/ masë sigurie/arrest në burg/ ekstradim/ Konventa për Ekstradimin/ pranim me rezervë/ Protokoll i 4-rt i KEDNJ-së/ parashkrim**

**Në kushtet e një përplasjeje normash mes nenit 10 të ndryshuar të Konventës për ekstradimin dhe nenit 491, shkronja “ë”, të KPP-së, janë normat e Konventës për ekstradimin që gjejnë zbatim, përfundim ky i arritur edhe nga Kolegji Penal në vendimin objekt shqyrtimi. Pra, në kushtet kur nuk është parashkruar dënimi në vendin kërkues, pavarësisht nëse është parashkruar në vendin e kërkuar, ekstradimi do të lejohet.**

## **Kleant Keshi (alias Gentian Hysa) (e drejta për të mos u dëbuar lidhur me ekstradimin) - vendimi nr. 78, datë 03.12.2025**

### *Faktet*

Kërkuesi, i deklaruar fajtor nga gjykatat italiane në tre procese penale dhe dënuar me mbi 5 vjet burgim, u shpall në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma. Në 2021 kërkuesi është arrestuar, e në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka caktuar ndaj tij masën e sigurisë “arrest në burg”, me qëllim ekstradimin në Itali.

Gjykata e Apelit Tiranë arsyetoi se, ndërsa për dy dënime Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër lejoi me të drejtë ekstradimin, për dënimin lidhur me veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, për sa kohë në një rast analog Italia do të refuzonte zbatimin e paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës për Ekstradimin, ishte rasti që të zbatohet parimi i reciprocitetit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e prokurorit, arsyetoi se gjykata e apelit në mënyrë të gabuar kishte aplikuar si kriter ndalues të ekstradimit (vetëm për veprën penale prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike) kriterin e parashkrimit të ndjekjes penale nga shteti i kërkuar (shteti shqiptar), dhe se interpretimi i saj bie ndesh me Protokollin e katërt shtesë të Konventës për Ekstradimin, që parashikon se ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhet sipas ligjit të palës së kërkuar.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për pretendimin lidhur me të drejtën për të mos u dëbuar* – Gjykata vlerësoi nëse ekstradimi i kërkuesit ishte bërë në respektim të nenit 39, pika 2, të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën vetjake për të mos u dëbuar, si dhe nëse ishte kryer brenda përcaktimeve të legjislacionit penal në raport edhe me parimin e reciprocitetit.

Gjykata konstatoi se Republika e Shqipërisë është palë në Konventën për Ekstradimin, po ashtu si shteti italian, ndërkohë që procedura e lejimit të ekstradimit për në shtetin italian të kërkuesit është bërë me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Lartë. Në lexim të kombinuar të neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës, aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj bëhen pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe kanë epërsi ndaj ligjeve që nuk pajtohen me të, dhe në këtë drejtim, Konventa dhe protokollet shtesë të saj renditen mbi legjislacionin penal vendas dhe kanë përparësi në zbatim ndaj tij.

Gjykata vërejt gjithashtu se në rastin konkret nuk rezultoi që Shqipëria të ketë paraqitur rezervë për ndryshimet e nenit 10 të Konventës për Ekstradimin, siç ka bërë shteti italian, pavarësisht se Konventa ia jep këtë të drejtë. Në këto kushte, siç edhe vetë Konventa parashikon, parimi i reciprocitetit nuk mund të zbatohet vetiu, por kërkon ushtrimin e këtij instrumenti nga ana e shtetit shqiptar, mbi të njëjtën dispozitë për të cilën ka paraqitur rezervë shteti italian. Lidhur me zbatimin e këtij instrumenti, Gjykata vëren, ndër të tjera, se edhe në një eventualitet të paraqitjes së rezervës, nuk janë gjykatat ato që e zbatojnë këtë parim dhe detyra e sistemit gjyqësor është vetëm verifikimi nëse plotësohen kushtet sipas parashikimeve të neneve 490 e vijues të KPP-së. Po ashtu, referuar KPP-së, autoriteti përgjegjës që disponon për ekstradimin është ministri i Drejtësisë, referuar nenit 499 të KPP-së. Gjithashtu, ministri i Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, është në pozicionin e duhur për të pasur informacionin e plotë për faktet që kanë rëndësi për parimin e reciprocitetit. Në këto kushte, referuar rrethanave konkrete të rastit, rezultoi se parimi i reciprocitetit, si një instrument i së drejtës ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor penal, nuk mund të zbatohet nga gjykatat e zakonshme, por nga autoritetet politike kombëtare. Ky konstatim i gjykatave të zakonshme nuk përmban ndonjë element antikushtetutshmërie, ndaj nuk ka vend të cenohet nga gjykata. Në këtë kontekst, Gjykata gjeti se me të drejtë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka rrëzuar si të pabazuara pretendimet e kërkuesit mbi zbatimin e parimit të reciprocitetit.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

**E drejta për gjykim të drejtë - Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor - Parimi i sigurisë juridike**

## **FJALË KYÇE**

*Vjetërsi shërbimi/ pensioni i parakohshëm/pagë referuese/ masë pensioni/ Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore/ fuqi prapavepruese e ligjit/ parimi i disponibilitetit/ vendim unifikues*

**Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara**

**Pensiononi i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës të ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike.**

## **Hajri Thaça (e drejta e përlllogaritjes së masës së pensionit të parakohshëm e fituar me ligj) - vendimi nr. 79, datë 12.12.2025**

### *Faktet*

Kërkuesi, oficer aktiv me gradën “Nënkolonel”, pasi u nxorr në vitin 2003 në rezervë, fillimisht u trajtua me pagesë kalimtare, dhe më tej, në vitin 2005 i lindi e drejta e pensionit të parakohshëm. Duke mos qenë dakord me masën e pensionit, ai u drejtua gjykatës, e cila vendosi të pranojë kërkesëpadinë, duke i kthyer diferencat e masës së pensionit nga data kur i kishte lindur e drejta në datën 30.04.2009. Vendimi u la në fuqi në apel, ndërsa Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të palës së paditur.

Referuar vendimit nr. 33/2010 të Gjykatës Kushtetuese, që shfuqizoi si antikushtetuese pikën 2, të nenit 14, si dhe nenin 27, të ligjit nr. 10142/2009, i cili trajton ndërmjet të tjerave sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura-, kërkuesi iu drejtua gjykatës duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së Tiranë, për të vazhduar pagesën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i moszbatimit të vendimit nr. 33/2010 për periudhën 01.05.2009-04.03.2013. Gjykata e shkallës së parë e pranoi kërkesëpadinë, dhe Gjykata Administrative e Apelit la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën të Apelit. Kundër këtij vendimi kërkuesi paraqiti ankim kushtetues individual, por me vendimin nr. 21, datë 19.12.2019, Kolegji i Gjykatës vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 4- mujor.

Ndërkohë, në vitin 2023, Gjykata Administrative e Apelit vendosi në rigjykim ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe rrezimin e padisë. Mbi rekursin e ushtruar nga kërkuesi, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike*, - Gjykata analizoi nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kishin bërë ligjit material të zbatueshëm i kishte cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore. Për sa i përket periudhës së përfitimit të pensionit të parakohshëm deri në datën 01.07.2009, Gjykata vërejti se pavarësisht shfuqizimit të tavanit maksimal të pensionit të parakohshëm me nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka përlllogaritur masën e pensionit sipas parashikimit ligjor në fuqi për atë periudhë, por ka përcaktuar se masa e përgjithshme e tij nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke vlerësuar se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohet për mungesë të daljes së akteve nënligjore për zbatimin e tij. Duke arsyetuar kështu, sipas Gjykatës, Gjykata Administrative e Apelit nuk duket se ka mbajtur parasysh ligjin për organizimin e gjykatave administrative, sipas të cilit gjykata e shqyrtonte ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë përlllogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se ka përmbushur konceptin e një gjykimi të drejtë në kuptim të parashikimit të nenit 42 të Kushtetutës.

Gjithashtu, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet t’u kthente përgjigje, sipas Gjykatës, pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Pra, ajo gjykatë nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte qoftë për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti nëse kufizimi “jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi” përfshinte edhe periudhën kohore 01.05.2009-01.07.2009. Prandaj vendimi i saj nuk plotëson kërkesat për një gjykim të drejtë në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i cenuar kërkuesit edhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të së drejtës për pension të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji, të paktën për periudhën kohore 01.05.2009-01.07.2009.

### *Vendimmarrja*

Gjykata, njëzëri, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës.

**E drejta për proces të rregullt ligjor - E drejta e aksesit - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

## **FJALË KYÇE**

***Ushtrim i ndikimit të paligjshëm/ punonjës policie/ diskriminim/ urdhër përjashtimi/ pushim hetimi/rigjykim/ dëmshpërblim shëndetësor dhe moral/ shfaqje e vullnetit të administratës publike***

**Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës .**

## **Gjergj Sokoli (cenimi i së drejtës së aksesit për shkak të mosnjoftimit të urdhërit të përjashtimit) - vendimi nr. 80, datë 16.12.2025**

### **Faktet**

Kërkuesi ish-punonjës i Policisë së Shtetit në qarkun Korçë, fillimisht u pezullua dhe më pas u përjashtua nga Policia e Shtetit “me urdhër përjashtimi” pas një procedimi penal për ushtrim të ndikimit të paligjshëm, që çoi edhe në dënimin e tij. Në lidhje me këtë proces, Gjykata e Lartë e ktheu çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë e cila vendosi kalimin e akteve të çështjes Prokurorisë, që nga ana a saj, pushoi hetimin. Kërkuesi iu drejtua Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë për rikthim në strukturat e Policisë së Shtetit, por nuk mori përgjigje.

Më pas, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me kërkesëpadi, ndër të tjera, për detyrimin për të përfutur pagat mujore nga data e arrestimit, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe dëmshpërblimin shëndetësor dhe moral.

Pas shqyrtimit të themelit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pranoi pjesërisht padinë, por Gjykata Administrative e Apelit prishi vendimin dhe e ktheu çështjen për rigjykim. Në këtë proces, gjykata e shkallës së parë pranoi pjesërisht padinë, ndërsa gjykata e apelit e pushoi gjykimin për shkak të paraqitjes së padisë jashtë afatit ligjor. Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit pasi mungonin shkaqet përkatëse ligjore. Kërkuesi paraqiti ankim kushtetues individual duke pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë duke qenë se, Gjykata Administrative e Apelit, duke pushuar çështjen për shkak të paraqitjes së kërkesëpadisë jashtë afatit, si dhe Gjykata e Lartë, duke mospranuar rekursin, nuk kanë shqyrtuar në themel pretendimin kryesor për mosnjoftimin e urdhrit për përjashtimin e tij.

### **Vlerësimi i Gjykatës**

*Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, -sa i takon pretendimit se gjykatat nuk kanë shqyrtuar në themel pretendimin kryesor për mosnjoftimin e urdhrit për përjashtimin, Gjykata evidentoi se, si rregull, gjatë procesit administrativ për largimin nga detyra, administrata, si punëdhënëse, nuk mund t'i shmanget detyrimit për t'i njoftuar individit aktin e largimit nga detyra. Megjithatë, Gjykata vërejti se kërkuesi ka qenë në dijeni të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, për rrjedhojë edhe të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, për shkak të arrestimit të tij. Në këtë drejtim, Gjykata vlerësoi se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm i përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ato kanë arsyetuar vendimet e tyre bazuar në provat e administruara në gjykim, të shqyrtuara dhe vlerësuara në tërësi dhe në harmoni me njëra tjetrën.*

Gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuesit për marrjen dijeni të urdhrit për përjashtimin, duke parashtruar argumente për rrëzimin e tij dhe interpretimi që i ka bërë ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, nisur edhe nga periudha e gjatë që ka kaluar nga momenti kur ka ndodhur largimi nga detyra i kërkuesit deri në paraqitjen e kërkesëpadisë, nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues, pasi kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për kërkimin e tij.

Gjithashtu, arsytimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloje vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Në përfundim, Gjykata çmoi se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

### **Vendimmarrja**

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

**E drejta për proces të rregullt ligjor – E drejta e aksesit-Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

## **FJALË KYÇE**

***Dëmshpërblim moral/ dëm pasuror/ diskriminim/ shprehje vullneti/ heqje dorë nga rekursi/akt-memorie/ notë verbale/ vendim themeli***

**Kolegji duhet të kishte vlerësuar me kujdes përmbajtjen e aktit/memories së depozituar nga pala, për të arritur në përfundimin se kërkesja kërkonte pushimin e gjykimit për shkak se çështja kishte mbetur pa objekt, duke iu referuar në fakt parashikimit të nenit 299, shkronja “c”, të KPC-së, sipas të cilit në rastet kur gjykimi nuk mund të vijojë më dhe kjo konstatohet prej gjykatave më të larta, ato prishin vendimin e gjykatës më të ulët dhe pushojnë çështjen.**

## **Deshire Subashi (cenimi i së drejtës së aksesit për shkak të pakujdesisë në interpretimin e vullnetit për të hequr dorë nga rekursi) - vendimi nr. 81, datë 16.12.2025**

### *Faktet*

Kërkesja, e emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë me vendim të ish- KLD në vitin 1993, u zgjodh në vitin 2003 anëtare e KQZ me mandat 7-vjeçar. Hyrja në fuqi e Kodit të ri Zgjedhor në vitin 2008 solli ndërprerjen para kohe të mandatit të saj, por në vitin 2009 ajo u rizgjedh nga Kuvendi si anëtare e KQZ-së dhe e ushtroi këtë funksion deri në përfundimin e mandatit në tetor 2012. Pas përfundimit të mandatit kushtetues, kërkesja iu drejtua tri herë KLD-së me kërkesa për rikthim në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, kërkesa që nuk u morën asnjëherë në shqyrtim, pavarësisht ekzistencës së vendeve vakante dhe faktit se KLD-ja kishte trajtuar kërkesa analoge të ish-anëtarëve të tjerë të KQZ-së.

Në këto rrethana, kërkesja paraqiti padi në gjykatat administrative, duke pretenduar diskriminim, shkelje të ligjit dhe duke kërkuar dëmshpërblim. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke disponuar, ndër të tjera, detyrimin e KLD-së, të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses, si dhe të dëmshpërblejë paditësen në masën një milion lekë për shkak të konstatimit të diskriminimit. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, për sa i përket masës së dëmshpërblimit (vendimi i themelit). Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur prishjen e vendimit të themelit të gjykatës së apelit vetëm për sa i përket kërimit për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin për këtë shkak, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim, ndërsa ka lënë në fuqi atë vendim për pjesën tjetër, sa i takon dëmshpërblimit të kërkuarës. Gjykata Administrative e Apelit, pas kërkesës së KLGj-së për sqarimin dhe interpretimin prej saj të vendimit të themelit, ka sqaruar me vendim dispozitivin e vendimit (të themelit). Ndaj këtij vendimi kërkesja ka paraqitur rekurs. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se kërkesja, nëpërmjet dy shkresave të saj, ka kërkuar pushimin e çështjes, bazuar në nenin 490 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Në vijim, kërkesja paraqiti ankim kushtetues individual.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* - Gjykata analizoi arsytimin e bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e kundërshtuar nga kërkesja, pra vlerësimin që iu bënë akteve të paraqitura nga kërkesja (notat verbale), për të kuptuar nëse ky vlerësim përkon me vullnetin e kërkuarës. Kështu, Gjykata konstatoi se nëpërmjet aktit nr. 5210 prot., datë 22.10.2024 (akti i dytë), nuk rezultonte që kërkesja të kishte hequr dorë nga shqyrtimi i rekursit. Jo vetëm kaq, por sipas këtij akti, Gjykata vërejti se kërkesja nuk i ishte referuar asnjëherë si bazë ligjore nenit 490 të KPC-së (rastet e heqjes dorë nga rekursi), as në formë dhe as në përmbajtje, por e gjendur përballë faktit se çështja e themelit ishte zgjidhur tashmë nga i njëjti kolegji i Gjykatës së Lartë, i kishte kërkuar kësaj të fundit të pushojë çështjen me objekt sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit, i cili kishte mbetur pa objekt. Gjykata evidentoi se me vlerësimin që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i kishte bërë aktit të dytë (notës verbale), nuk kishte analizuar drejt vullnetin e shprehur nga kërkesja, duke interpretuar në mënyrë të pakujdesshme vullnetin e saj. Për rrjedhojë, duke vendosur mospranimin e rekursit, Kolegji nuk u kishte dhënë në substancë përgjigje pretendimeve të saj.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

### Shpronësimi për interes publik lejohet vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë

#### FJALË KYÇE

*Shpronësim për interes publik/ shpërblim i drejtë/ ligji për shpronësimet/ vlera e pronës/ kriteret teknike të vlerësimit/ metodologjia e vlerësimit të pronave/ vlerësimi paraprak/ vlerësimi përfundimtar/ akti i ekspertimit/vlera e tregut/ ekuilibrimi i interesave*

**Qëllimi i shpërblimit sipas nenit 41, pika 4, të Kushtetutës, është të rivendosë një gjendje “të barasvlershme me gjendjen e mëparshme”. Thelbi i garancisë kushtetuese është të garantojë ekuilibrin midis interesit publik dhe shuarjes të së drejtës së pronës së individit, prej nga rrjedh detyrimi i prerë dhe i pakushtëzuar i shtetit për të siguruar një shpërblim të drejtë për shpronësimin. Ky shpërblim mund të korrespondojë me një vlerësim të plotë, por mund të jetë edhe më i ulët, pasi llogaritja e tij nuk merr në konsideratë vetëm interesin e individit të prekur, por e peshon atë në raport me interesin publik.**

**Autoritetet kompetente, gjatë procedurës së shpronësimi, dhe më tej gjykatat e zakonshme, gjatë procesit gjyqësor, duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjithë faktorët relevantë për përcaktimin e shpërblimit nga shpronësimi për të arritur ekuilibrin e duhur dhe për të mos i vendosur individit një barrë të tepruar.**

### **Klodiana Cankja, Ermelinda Cankja, Ardit Cankja, Drita Cani, Suzana Cani, Marvis Cani, Engjëll Tirana, Brian Tirana, Helga Hasekiu (proporcionaliteti i shpërblimit si rrjedhojë e shpronësimi të pronës për interes publik) - vendimi nr. 82, datë 18.12.2025**

#### Faktet

Këshilli i Ministrave ka shpronësuar dy prona (truall dhe ndërtesë) të kërkuesve sipas Ligjit për Shpronësimet, bazuar në kërkesën e bashkisë me qëllim sistemin e një rruge brenda qytetit. Me pretendimin se, vlera e shpërblimit nuk ishte e drejtë, kërkuesit kanë paraqitur padi në gjykatë. Gjatë gjykimit është administruar akti i ekspertimit lidhur me përlogaritjen e shpërblimit sipas vlerës së tregut, e cila pothuajse e trefishonte shpërblimin e kërkuesve. Në përfundim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës e ka rrëzuar padinë, pasi, sipas saj, shpërblimi ishte llogaritur bazuar në aktet nënligjore në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për shpronësim, ndërsa akti i ekspertimit nuk kishte vlerë të paracaktuar provuese dhe nuk lidhej me provat e tjera të shqyrtuara. Sipas gjykatës, vlera e shpronësimi duhej përcaktuar sipas një metodologjie shtetërore, në mënyrë që të mos cenohet përmbushja e interesit publik. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa Gjykata e Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, të cilët më pas i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

#### Vlerësimi i Gjykatës

*Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës - Kufizimi i ligjshëm i së drejtës së pronësisë kërkohet të realizohet me “ligj”, “vetëm për interesa publikë” dhe “vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë”, ndaj Gjykata analizoi nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm për vlerën e shpërblimit, pra nëse përmbushet kriteri për proporcionalitetin e ndërhyrjes duke qenë se u provua që kërkuesit kanë pësuar ndërhyrje me ligj dhe për interes publik në të drejtën e pronësisë. Gjykata konstatoi se, megjithëse rekursi i kërkuesve për mungesën e arsytimit nga gjykata e apelit për shpërblimin e drejtë nga shpronësimi kishte të bënte me një shkelje potenciale të të drejtave kushtetuese, të cilën gjykatat e zakonshme kanë detyrimin ta shqyrtojnë me kujdesin e duhur, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje të shprehur këtij pretendimi, i cili ishte vendimtar për zgjidhjen e çështjes. Për rrjedhojë, kërkuesve u janë cenuar të drejtat kushtetuese të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës i lidhur me nenin 41, pika 4, të saj nga vendimi i Gjykatës së Lartë.*

Gjykata, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit, e ktheu çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila nuk ka asnjë pengesë ta zgjidhë vetë ose të orientojë zgjidhjen e saj nga gjykata më e ulët, duke njësuar e zhvilluar edhe praktikën gjyqësore në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato të GJEDNJ-së të trajtuara në këtë vendim.

#### Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

**E drejta për proces të rregullt ligjor - E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj - Standardi i arsyeimit të vendimit gjyqësor**

## FJALË KYÇE

*Kontratë sipërmarrjeje/ mospërbushje detyrimesh/ penalitet kontraktor/ akt ekspertimi/ dëmshpërblim/ shtim i objektit të padisë/ pavlefshmëri e klauzolës kontraktore/ vlerë padie/ fletëthirrje/ racione temporis*

**Në lidhje me vlerën e kërkesëpadisë, si një kusht thelbësor në përcaktimin e përbërjes së rregullt të trupit gjykues sipas dispozitave të KPC-së, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se vlera e padisë përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar për gjykatën e caktuar me ligj.**

**Gjykatat e zakonshme duhej të kishin arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për të përcaktuar momentin e marrjes dijeni nga ana e kërkujeses për vlerën finale të objektit të padisë (mbi 20 milion lekë), sepse nga ky moment ajo mund të kërkonte gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, si një e drejtë që i njihet nga ligji, ose do të parashtronte prapësimet/ mbrojtjen e saj lidhur me shtimin e objektit të padisë.**

## Shoqëria “Industri Ndërtim” sh.p.k (cenimi i së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj) - vendimi nr. 83, datë 18.12.2025

### Faktet

Kërkuësja nënshkroi një kontratë sipërmarrjeje me subjektin e interesuar K.I., për ndërtimin e dy godinave. Ky i fundit, për mospërfundimin e objektit sipas kushteve të kontratës, i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke kërkuar edhe dëmshpërblim sipas penaliteteve të parashikuara në kontratë. Në vijim të procesit (që është zhvilluar në 24 seanca dhe kërkuësja ka marrë pjesë vetëm në 2), subjekti i interesuar ka kërkuar dhe shtimin/saktësimin e objektit (vlerës) të padisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë vendosi pranimin e padisë dhe detyrimin e kërkujeses ndaj subjektit të interesuar, në shumën 196.800 euro, si dhe vlerën shtesë 11.876.36 euro për çdo muaj (penalitetin kontraktor prej 1%), deri në momentin e ekzekutimit përfundimtar të vendimit. Gjykata e Apelit Shkodër la në fuqi vendimin e shkallës së parë dhe konsideroi të pabazuar pretendimin e kërkujeses për formimin e trupit gjykues prej tre gjyqtarësh me shtimin e objektit të padisë.

Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkujeses dhe në lidhje me kërkimin për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, ajo arsyetoi se kërkuësja nuk kishte respektuar nenin 35 të KPC-së gjatë gjykimit në shkallë të parë, arsye për të cilën, kërkesa u konsiderua e rënë në dekadencë.

Kërkuësja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual, e cila vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim, për shkak të mosplotësimit të kriterit *ratione temporis*.

Në vijim, kërkuësja pretendoi cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në GJEDNJ, e cila konstatoi se kërkuësja ishte cenuar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, vendosi shfuqizimin e vendimit të saj të mëparshëm, rihapjen e procesit dhe kalimin e çështjes për shqyrtim.

### Vlerësimi i Gjykatës

*Për cenimin e standardit të arsyeimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* - Gjykata vlerësoi se ndonëse mosparaqitja e kërkujeses në të paktën 20 seanca gjyqësore, mund të duket si e qëllimshme ose abuzive, kjo nuk i justifikon gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe Gjykatën e Lartë që të mos i japin përgjigje të argumentuar pretendimit për gjykatën e caktuar me ligj dhe gjykimin e çështjes me trup gjykues me tre gjyqtarë për shkak të vlerës së objektit të padisë, duke u mjaftuar vetëm me një referencë në nenin 158/a të KPC-së.

Gjykata vlerësoi gjithashtu, se kërkuësja nuk mori përgjigje për pretendimin për pavlefshmërinë e klauzolës kontraktore që parashikonte penalitetin 1% mbi vlerën e detyrimit të papërbushur, e cila ishte përcaktuese për vlerën e objektit të padisë.

Në përfundim, pavarësisht se në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë pasqyruar pretendimet e kërkujeses, përfshirë edhe ato që lidhen me themelin e çështjes për sa i përket vlefshmërisë së penalitetit kontraktor, ajo nuk ka analizuar mjaftueshëm pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkuësja në lidhje me respektimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë.

### Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

**E drejta për proces të rregullt ligjor - Parimi i sigurisë juridike – E drejta e lirisë personale - Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

## FJALË KYÇE

*Parimi ne bis in idem/ dënim penal/ para-burgim/ masë dënimi/ arrest me burg/ arrest në shtëpi/ aplikim i nenit 59 të KP-së/ vënie në provë/ shuarje e masës së sigurimit/ vendim i gjykatave të huaja/ ekstradim/ njohje e vendimit penal të huaj/ dekreti legjislativ nr. 286/1998 / masë dëbimi/ nenet 512 e vijues të KPP-së/ ekzekutim i dënimeve penale*

**Në procesin penal parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, i lidhur ngushtë me mbrojtjen e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi.**

## **Klement Shehu (cenimi i parimit të sigurisë juridike në procesin e njohjes së vendimit të huaj) - vendimi nr. 84, datë 22.12.2025**

### Faktet

Kërkuesi është dënuar me vendim përfundimtar nga gjykata italiane dhe, në kuadër të këtij dënimi, Gjykata e Rrethit Gjyrokastër ka caktuar fillimisht ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg” për qëllime ekstradimi, nën të cilën ai ka qëndruar në burg për 1 muaj e 7 ditë, e në vijim masën “Arrest në shtëpi”, për qëllim njohjen e vendimit penal italian. Më pas, po kjo gjykatë ka njohur dënimin penal italian prej 4 vjetësh e 21 ditësh, ndërsa ka pezulluar ekzekutimin e tij, duke e vënë kërkuesin në provë.

Ndërkohë, gjatë kohës që çështja ishte për shqyrtim në gjykatën e apelit mbi bazën e ankimit të prokurorisë, kërkuesi ka udhëtuar drejt Greqisë, ku është ndaluar nga autoritetet greke në zbatim të urdhër-arrestit ndërkombëtar të lëshuar ndaj tij nga autoritetet italiane dhe është ekstraduar në Itali, ku ka vazhduar të vuajë dënimin e dhënë nga gjykata italiane. Ndërsa i kishin mbetur më pak se dy vite nga vuajtja e plotë e dënimit, bazuar në rregullat e emigracionit dhe masat ndaj të huajve, autoritetet italiane kanë caktuar ndaj kërkuesit masën alternative të dëbimit.

Pas kthimit në territorin shqiptar kërkuesi i është drejtuar gjykatës së apelit për mospranimin e ankimit të prokurorisë, duke parashtruar se kishte vuajtur tërësisht dënimin e dhënë nga shteti Italian. Ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit për sa i përket njohjes së vendimit penal italian, gjykata e apelit e ka ndryshuar atë për sa i përket pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vendosjes së kërkuesit në provë. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për vuajtjen e dënimit të plotë në Itali, gjykata e apelit ka vlerësuar se ai duhej t’u drejtohej gjykatave me kërkesë të veçantë për shuarjen e dënimit. Në zbatim të këtij vendimi prokuroria ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, sipas të cilit kërkuesit i kishin mbetur për të vuajtur 3 vjet, 6 muaj e 25 ditë burgim, i cili nuk është ekzekutuar. Kërkesa e kërkuesit për pezullimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe rekursi i tij nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë.

Përpara dhënies së vendimeve të lartpërmendura nga Gjykata e Lartë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për shuarjen e dënimit, e cila ka vendosur rrëzimin e saj, me arsytimin se, sipas nenit 11 të ligjit nr. 79/2020, procedura për ekzekutimin e dënimeve penale vihet në lëvizje nga prokurori. Në vijim, pas vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Prokuroria e Gjyrokastërës ka vendosur shfuqizimin e urdhrin të saj për shkak se kërkuesi kishte vuajtur dënimin e dhënë në Itali, si dhe ka urdhëruar Drejtorinë Vendore të Policisë Gjyrokastër për heqjen e kërkuesit nga kërkimi.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

### Vlerësimi i Gjykatës

*Legjitimimi racione personae* - Në kushtet kur kërkuesi nuk është privuar efektivisht nga liria personale, pasi vendimet e kundërshtuara nuk kanë sjellë pasoja ndaj tij, Gjykata vlerësoi se ai nuk legjitimohet *racione personae* për pretendimin e cenimit të kësaj lirie, ndërsa legjitimohet për pretendimet e tjera.

*Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë së armëve*, - Gjykata vlerësoi se në rastin konkret nuk gjen zbatim parimi *ne bis in idem*, për sa kohë kërkuesi nuk ndodhet në situatën kur për të njëjtin fakt penal juridiksioni gjyqësor shqiptar të ketë dhënë dy vendime, pra atë të njohjes dhe një vendim tjetër penal.

(vijon në faqen 25)



Në vijim, Gjykata vërejt se gjykatat e zakonshme, duke mos respektuar parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, kanë zbatuar formalisht ligjin, duke ia kaluar kompetencën për riparimin e situatës prokurorisë, e cila ndonëse *de facto* ka shfuqizuar urdhrin e saj të mëparshëm për burgosjen e kërkuarit, sipas sistemit tonë ligjor ka kompetencën të ekzekutojë vendimet gjyqësore dhe jo të ndryshojë thelbin e vendimmarrjes gjyqësore. Ato gjykata kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuari, në cilësinë e individit, duke e vënë atë në pozicion të pafavorshëm me prokurorinë, e cila si subjekti që ka vënë në lëvizje procedurën e njohjes, ka detyrimin të provojë në gjykim ekzistencën e një vendimi të ekzekutueshëm, të vlefshëm për njohje. Kërkuari duket se është vënë në situatën, ku krahas një dënimi të caktuar nga një juridiksion i huaj, ekzekutimi i të cilit është ndërprerë, me anë të caktimit të një mase alternative (dëbim) ndaj tij përmes njohjes, është caktuar sërish dënimi me burgim 4 vjet e 21 ditë. Në kushtet kur ekzekutimi i dënimit të vendimit penal të gjykatës italiane lidhej drejtpërsëdrejti me procesin e njohjes në Shqipëri të atij vendimi, Gjykata vlerësoi se ndryshimi i situatës juridike të kërkuarit duhej të ishte trajtuar nga Gjykata e Lartë në kuadër të garantimit të parimit të sigurisë juridike në fushën penale. Duke mos marrë në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete, përmes mospranimit të rekursit Gjykata e Lartë ka lejuar ekzekutimin e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuarit nga gjykata italiane, veprim që nuk përputhet me funksionin e saj si gjykatë ligji. Gjykata çmoi se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë së armëve janë të bazuara.

### *Vendimmarrja*

Gjykata, me shumicë votash, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës.

### **E drejta për proces të rregullt ligjor – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

#### **FJALË KYÇE**

**Forca të Armatosura/ ushtarak aktiv/kolonel/ Ligji për Karrierën Ushtarake/ e drejtë page/rikthim në detyrë/lirim për shkelje disiplinore /mjet jetese/ punë e ligjshme /gjë e gjykuar**

**Gjykata, duke marrë në konsideratë se Ligji për Karrierën Ushtarake mund të interpretohet në disa mënyra lidhur me kohëzgjatjen e së drejtës së ushtarakut për t'u paguar gjatë kohës në dispozicion, rritet se kur ekziston mundësia që ligji të interpretohet në më shumë se një mënyrë, të cilat japin rezultate të ndryshme, atëherë duhet përzgjedhur interpretimi që passjell rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve.**

**Gjykata, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, rritet se roli i pazëvendësueshëm të Gjykatës së Lartë, së cilës i përket detyra kushtetuese për të siguruar njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ajo gjykatë nuk ka asnjë pengesë të zgjidhë vetë çështjen ose të orientojë zgjidhjen e saj nga gjykata më e ulët, duke njësuar dhe zhvilluar edhe praktikën gjyqësore në përputhje me standardet kushtetuese, të trajtuara në këtë vendim.**

### **Ylli Zyla (cenimi i të drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punën e ligjshme të ushtarakut) - vendim nr. 85, datë 23.12.2025**

#### **Faktet**

Kërkuesi, ushtarak aktiv me gradën “Kolonel”, u lirua nga detyra dhe u vendos në dispozicion të Forcave të Armatosura me të drejtë page për dy muaj, sipas nenit 26 të Ligjit për Karrierën Ushtarake, por nuk u sistemua në detyrë tjetër dhe pagesa iu ndërpre. Në vijim të kërkesës administrative për risistemim, ai iu drejtua gjykatës duke kërkuar rikthimin në detyrë ose emërimin në një funksion ekuivalent dhe pagesën e plotë deri në rikthim. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e pranoi pjesërisht padinë duke urdhëruar pagesën deri në emërim ose lirim, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit rrëzoi vendimin dhe pushoi gjykimin, me arsytimin se pagesa përtej dy muajve nuk parashikohej nga ligji dhe se padia ishte ngritur në mënyrë të papërshtatshme. Rekursi i kërkuesit nuk u pranua nga Gjykata e Lartë.

Ndërkohë që u nxor në lirim për shkelje disiplinore, kërkuesi ngriti sërish një padi në gjykatë për pagesën e periudhës së mbajtjes në dispozicion deri në datën e lirimit, padi e cila u rrëzua nga gjykata e shkallës së parë me arsytimin se detyrimi për pagesë kufizohej në dy muaj dhe se çështja ishte gjë e gjykuar. Gjykata Administrative e Apelit la në fuqi vendimin ndërsa Gjykata e Lartë vendosi sërish mospranimin e rekursit. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

#### **Vlerësimi i Gjykatës**

*Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit në lidhje me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*—Gjykata analizoi nëse Gjykata e Lartë kishte arsyetuar mjaftueshëm lidhur me të drejtën e kërkuesit për të fituar mjetet e jetesës me punën e ligjshme të ushtarakut. Në këtë drejtim, Gjykata konstatoi se rekursi i kërkuesit kishte të bënte me një shkelje potenciale të të drejtave kushtetuese, të cilën gjykatat e zakonshme kishin detyrimin ta shqyrtonin me kujdesin e duhur, dhe se Gjykata e Lartë kishte vendosur mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje të shprehur pretendimit vendimtar për zgjidhjen e çështjes.

Sipas Gjykatës, pretendimi ka të bëjë me kufizimin e papërligjor që kërkuesit i është vendosur në drejtim të së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, pasi, nga njëra anë, ai është mbajtur në dispozicion pa u sistemuar në punë, shkak për të cilin i ndalohej të zgjidhej ose emërohej në detyra të tjera jashtë Forcave të Armatosura dhe, nga ana tjetër, nuk është paguar. Gjykata vlerësoi se kërkuesit i janë cenuar të drejtat kushtetuese të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës i lidhur me nenin 49, pika 1, të saj.

#### **Vendimmarrja**

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.